

BIBLIOTEKA E

85 H - 32

SHTETIT

M - 32

GJIROKASTER

NDESHJE

TREGIME

8SH-32
N 32

8SH-32
S
2

N D E S H J E

T R E G I M E

~~4982~~
LIBYERIA E SHTEPIA
GUROBETIP
2801

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

DY FJALE PËR LEXUESIT

Në këtë vëllim që po i japim sot lexuesit, janë përbledhur disa tregime nga autorë të ndryshëm. Këto tregime janë nxjerrë nga organet letrare dhe të shtypit periodik me qëllim që të shërbejnë për popullarizimin dhe njohjen më të plotë të shkrimeve tona letrare më të fundit.

Tematika që trajtohet nëpër tregimet e kësaj përbledhjeje është e larne. Në disa tregime si «Xhemilja», «Çapkënja e gjyshes», «Ndeshje» përshkruhet lufta dhe përpjekja e madhe që bëhet sot te ne për flakjen e zakoneve të prapambetura që skllavërojnë gruan, këtë forcë të madhe shoqërore. Autorët kanë vënë në qëndër heroinën që lufton kundër koncepteve të mykura, të cilat kanë zënë rrënje në njerëz të afërm apo në prindër që akoma s'janë bashkuar me rymën e fuqishme të revolucionarizimit të jetës sonë.

Kurse në tregimet si «Këngë e re», «Me pleqtë e Perondisë», «Shpërndajja» etj. autorët kapin dhe trajtonë subjekte që evidencojnë luftën në ndërgjegjen e një pjese të kooperativistëve tanë për të hequr dorë vullnetarisht nga pronësia private e tokës në interes të shoqërisë sonë.

Ndjenja e dashurisë së madhe ndaj pronës ko-

lekptive spikat bukur te tregimi «Dhimbje». Kurse një jehonë të Luftës Nacional-çlirimtare lexuesi do ta ndeshi bukur te tregimi «Plaku dhe pushtuesi».

Për problematikën që trajton dhe për nivelin e kënaqshëm artistik, mendojmë që ky vëllim do të pëlqehet dhe do të lexohet me ëndje.

TIPUZTEI SHY KIALEY YAI

„**Εποιείται** η απόλυτη παραγωγή της γνώσης στην αρχαία Ελλάδα».

XHEMILJA

Atë ditë prilli, në shtëpinë e Zeman Kapllanit bëhej një gosti e madhe. Do të vendosej fati i Xhemiles, vajzës së tij të vetme. Kishin ardhur pér të parë vajzën. Zemani ishte pregetitur me kohë pér këtë ditë; vetëm një diçka i kishte dalë nga mendja atij: nuk kishte mbajtur vajzën në shtëpi, po e kishte lënë të shkonte në punë. Atij iu kujtua kjo gjë, sa po miqtë në kthesën e rrugicës dhe në kokë i shkrepi si rrufe një mendim: Thirri djalin dhe e porositi të lajmëronte Xhemilen të vinte me një frymë në shtëpi, se kish ardhur daja. Djali, sikur ta kishte kuptuar shqetësimin e tij, megjithëse nuk kishte parë të vinte daja, pa e bërë fjalën dysh u nis në pikë të vraptit, sa i hanin këmbët, pér të zbatuar urdhërin. «Deritanë çdo gjë po shkon sahat» — mendoi i kënaqur xha Zemani dhe, duke përdredhur majat e mustaqeve (zakon ky që tregonte kënaqësinë, sa herë që shpëtonte nga ndonjë telash) nxitoi të priste miqtë.

Në odën e miqve kishin zënë vend: miqtë në qoshen e djathtë, të kryesuar nga Asllani, lajmësi, i cili ishte edhe daja i vajzës. Poshtë tij ishte ulur zonja Ronjë, e ëma e «kandidatit pér dhëndërr» dhe i treti e i fundit ishte vetë personi më i inte-

resuar, i vluari Xheviti Molla. Kundruall «delegacionit» të miqve, në qoshen e majtë ishin të zotët e shtëpisë: xha Zemani, i vëllai dhe i nipi.

Mbas prezantimit të bërë nga lajmës Asllani, që ishte lindur për kësi ceremonish, të dy palët ishin njohur me njëri-tjetrin. Ishin shkëmbyer përshtendetjet e rastit, ishin hedhur e pritur cigaret nga njëra qoshe në tjetrën (tamëm si në një lojë «luftash»), ishte pirë dhe kafja e parë, dhe muhabeti sikur s'po gjallërohej, sikur fjala nuk po merrte udhën e duhur, drejt qëllimit që duhej. Si miqtë dhe zotët e shtëpisë sikur rrinin mbi gjembë, të gjithë prisin çastin kur të hynte Xhemilja dhe të sillte kafen e dytë.

Ndërkaq Xhemilja, sa pa të vëllanë që vinte me vrap drejt saj, u nda nga shoqet dhe e trondituri i doli përpara. Nuk arriti ta pyesë, kur dëgjoi atë të fliste duke iu marrë fryma nga lodhja:

— Xhemile... më tha babai... të vish shpejt në shtëpi... se ka ardhur daja.

Sakaq Xhemilja, nuk kërkoi asnjë sqarim tjetër nga vëllai, nuk arriti as t'u thoshte gjë shoqeve, kapi vëllanë për dore dhe u nis me vrap. Nuk i pëlqeu aspak kjo ardhje me kaq ngut e të vëllait. Diçka e keqe duhej të kishte năodhur në shtëpinë e dajës ose në shtëpinë e saj. E pushtuar nga një ndjenjë frike ecte vrap, pa vënë rë asgjë përreth, dukej sikur fluturonte dhe tërhoqte zvarrë të vëllanë, i cili nuk ecte më me këmbët e veta. «Daja ka ardhur edhe herë të tjera te ne — mendonte ajo — po nuk më kanë thirrur me kaq ngut, me siguri diçka e keqe ka ndodhur» dhe vazhdonte vrapin me këtë mendim të ngulur në tru. Kur ishte duke ngjitur shkallët, i doli për-

para e ēma me fytyrë tē qeshur dhe e qetë i tha:

— Po eja moj bijë, se po tē presin gjithë ata miq.

«Nuk po kuptoj asgjë — ç'të jetë kjo lojë që po më kurdisin?» dhe, pa iu përgjigjur së emës, hyri në kuzhinë. Aty u kujtua për tē vëllanë, që ishte i rraskapitur dhe i bërë ujë në djersë. E freskoi me ujë dhe filloi ta fshinte me peshqir, duke mallëkuar veten që kishte vrapiuar si e çakërdisur.

— Hajde, lëre Agimin tani, se freskonet vetë ai, po vishu shpejt, se po tē presin në odën e miqve. Shiko, vish atë fustanin bojë qielli dhe sandalet e reja — dëgjoi urdhërin e nënës.

— Pse t'i vesh rrobet e mira? — pyeti Xhemilja me sinqueritetin e një vajze tē padjallëzuar.

— Daja më ka parë edhe herë tē tjera me rrobet që mbaj zakonisht.

— Lëri pyetjet tani, ti, Xhemile, dhe bëj si tē thonë, se nuk është koha për muhabet! More vesh?

Për tē mos i prishur qejfin nënës, Xhemilja u vesh shpejt e shpejt.

— Tani merr tabakanë me filxhanët e kafes dhe llokumet e eja tē hyjmë.

E ēma para, Xhemilja pas, u nisën për në odën e miqve.

Padurimi kishte arritur kulmin më odën e miqve. Kishte pllakosur një heshtje, saqë asnjërit s'ja mbante tē hapte gojën i pari. Më tē rrallë, si për tē thyer heshtjen, e merrte fjalën Asllani, që ishte i zoti i gojës edhe në situatë tē vështirë. Por arriti momenti që edhe lajmësit iu lidh gjuha e nuk dinte përsë tē hapte muhabet, dhe u mat t'i drejtohej xha Zemanit që tē nxirrte vajzën, se

koha s'priste, po s'arriti të hapte as gojën, kur dëgjoi të hapej dera dhe të hynte Xhemilja. Të gjithë, në të njejtën kohë, sikur atë çast prisnin dhe sikur të komandoheshin nga ndonjë sustë, lëvizën nga vendi dhe i drejtuani sytë nga ajo. Të shihnit si ndërruan fytyrat e tyre! Të gjithë u çelën në fytyrë. Edhe xha Zemani, që deri tani nxinte si kllaniku, i trembur se mos e bija i binte hilesë dhe i bënte ndonjë proçkë e nuk vinte fare në shtëpi, lëvizi nga vendi, duart automatikisht filluan të kryenin funksionin, të përdridhnin majat e mustaqeve, u çel në fytyrë dhe mori një pamje prej kapadaiu, sikur donte t'u thoshte të pranishmëve: «E shikoni se ç'vajzë kam? Yll, ore yll, që me dritën e tij na ndriçoi dhomën».

Sikur t'ja kishin kuptuar mendimet që bluante në kokë xha Zemani, të gjithë ja kishin ngulur sytë Xhemiles. Zonja Rronjë, bile, u rrotullua pak që ta kishte Xhemilen përballë dhe po e shikonte sikur ajo të ishte ndonjë plaçkë e eksposuar. Më finok u tregua Xheviti, i cili u hoq sikur s'e vuri re Xhemilen, por, megjithatë, me ato shikimet vjedhurazi nuk ja shqiti sytë për asnjë çast.

Xhemilja nuk kujtonte të gjente njerëz të huaj në odë dhe, e hutuar nga gjithë ato vështrime, mbeti si e gozhduar atje, në fund të odës, me kokë ulur dhe tabaka në dorë. E ëma e preku lehtë në bërryl dhe i pëshpëriti në vesh: «Jepu kafen, nise nga qoshja e djathtë e pastaj me radhë...» dhe nuk arriti të mbarojë se Asllani, i vëllai, sikur ta kishte kuptuar shqetësimin e saj, i erdhi në ndihmë:

— Hajde, të keqen daja, mos ki turp, pa ta provojmë një herë kafen nga dora jote! — nisi

nga ligjérata daja dhe shikimi i tij fluturoi te të gjithë, por vajti e u ngul te Xheviti, sikur donte t'i thoshte: «shiko, hapi sytë mirë, more tutkun, e shikon se ç'thellëzë të kemi zgjedhur?»

Përsëri ra heshtja. Dëgjohej vetëm të rufisurit e kafes dhe në të njejtën kohë kryqëzoheshin shikime. Xhemilja, kokëulur, vazhdonte të qendronte me tabakanë në dorë, duke pritur të mbledhë filxhanët. Edhe ashtu, kokëulur, ajo ndjente shikimin e të gjithëve, po sidomos të asaj gruas dhe djalit, që ajo nuk i njihte. Ishte në një gjendje të tillë, saqë nuk mund të mendonte për asgjë. Pse të gjithë e shikonin dhe nuk flisnin? Nuk kishin parë njeri me sy? Po ajo gruaja dhe ai djali, ç'kishin që e shikonin sikur do ta përpinin? Munduhej t'u kujtonte ftyrat, por më kot. Një gulç ndjente në grykë, dhe sikur e pengonte të qante me zë.

Tani ajo e kuptoi se ata ishin mbledhur për ta fejuar. Dhe si pa? Pa i thënë më parë asaj asnjë fjalë! Kur? Si kështu? Ajo nuk ishte në gjendje të arësyetonte më shumë, kaq e tronditi ky zakon anadollak, që këtë herë ajo po e provonte në jetën e saj. Të mos kishte qenë e ëma aty pranë, që e kapi për krahu, ajo me siguri do të ishte rrëzuar në dysheme.

Xheviti, mbasi e shikoi mirë e mirë Xhemilen, filloi të pijë kafen, shenjë kjo që, sipas zakonit, jepte pëlqimin për vajzën. E piu kafen dalëngadalë, që të kishte sa më shumë kohë në dispozicion për të parë Xhemilen. Mbasi vuri filxhanin në tabaka, nxori një unazë ari dhe u mundua t'ja vinte në gisht Xhemiles, por kjo u kthyë me rrëmbim dhe doli nga oda.

Cigaret, kafeja dhe llokumet u pasuan me gotat e rakisë, që u rrrokullisën atë darkë në shtëpinë e Zeman Kaplanit. Karkë, për kokën e darkës. U mblodhën gjithë tarafi i xha Zemanit dhe muhabeti zgjati derisa këndoi gjeli i tretë. S'i thonë shaka! Fejoi vajzën e vetme xha Zemani! Dhe me kë pa, me Xhevít Mollén, alamet dhaskali nga fshati fqinj.

Ndërsa në odën e miqve kërciste muhabeti për shtatë palë qejfe, rakia derdhej si lumë e dëgjojeshin këngë e valle, ngriheshin dolli e mirësi për çiftin e ri, në dhomën tjetër nënë Zenepja jepte e merrte për të qetësuar Xhemilen, që, e dërrmuar, qe shtrirë mbi minder. Fytyra, shtrënguar në mes të pëllëmbëve të duarve, i digjte furrë. Koka i oshëtinte si koshere bletësh, dhe në tëmtha ndjente dhembje sikur ta shponin me turjelë. Ishte kaq e brengosur, saqë donte me çdo kusht të shfrynte, të nxirrte dufin, por te kush? S'kishte kujt t'i drejtohej. Babait?! Jo dhe jo! Punë që s'bëhej. Ja njihte mirë huqet atij. Me të s'mund të bisedonte e t'i thonte mendimin e saj për këtë fjesë të padrejtë. Po edhe sikur të merrte guximin e t'ja thonte, mos vallë ai do ta kuptonte dhe dc ta përkrahte? Xha Zemani nuk ishte nga ata burra që të pyeste evlatin për raste të tilla dhe aq më tepër vajzën! «Evlati është evlat — trumbetonte ai — dhe duhet të mbajë vendin e tij, të mos përzihet në punët e më të mëdhenjve. Po t'u fërkosh pak kokën, të hipin në kurriz. Evlatin vishe, ushqëje dhe mos e pyet për asgjë. Për jetën e tij ka kush përgjigjet» — ja parimet e xha Zemanit. T'i drejtohej së émiés? Po si mund ta ndihmonte ajo? Qëkur kishte hyrë nuse në këtë shtëpi, s'e kishte hapur asnjëherë go-